ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit	**328-22-12042-1-1-1**
Nr i brendshëm	**33300/022/038/111**

Sa i përket tenderit për: **"Furnizim me Inventar për Salla te gjykimeve dhe Zyra te Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"Graniti" SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ibrahim Rugova p.n Shirokë
(Adresa)

Suharekë
(Vendi)

23000
(Kodi postar)

044-111 572
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Bajram Lumi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

granitiholding@gmail.com
(Adresa elektronike)

12.01.2023
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 02.12.2022 Data e hapjes së ofertave: 13.12.2022 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 29.12.2022 Kërkesa për rishqyrtim: 04.01.2023 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 05.01.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së.
Neni 41 i Rregullores për prokurim publik Nr.001/2022

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. 29.12.2022 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku e ka rekomanduar për kontratë OE "MOBELLAND " SH.P.K, ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të pasuksesshëm.

AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Tek kërkesat e FDT-së mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 është kërkuar: *Inventari te deshmohet me fotografi per secilin artikuj (perjashtimisht sallave te gjykimit dhe zyrave te shkrimoreve),* si dëshmi dokumentare të ofrohet: *Katallogu per artikujt e ofruar nga OE per secilin veç e veç te Evidentohen sipas numrit Rendor.*

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se **NUK ka prezantuar katalog dhe specifikacion teknik** konform kërkesës së dosjes së tenderit. OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar vetëm foto dhe ato foto i ka kopjuar bashkë me specifikimet nga dosja e tenderit, pra ka vendosur foto të marra nga dosja e tenderit. Andaj ky fakt tregon qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se nuk e ka prezantuar katalogun konform kërkesës së dosjes së tenderit, mirëpo fotot i ka kopjuar nga dosja e tenderit, ku ky fakt vërtetohet shumë lehtë nëse analizohet oferta e OE të rekomanduar për kontratë, mirepo AK haptas ka bere favorizime.

Po ashtu edhe këto foto apo i menduari si katalog i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë në shumë pika nuk ofron dëshmi dhe të dhëna të sakta në lidhje me materialin dhe specifikat tjera të kërkuar. Edhe teksti ku përshkruhen të dhënat e produkteve pothuajse janë të njëjtat, ku thuhet që **duhet të jenë,** ndërsa diku teksti është përshtatur. Prandaj dëshmohet qartë se ky OE është i pa përgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të eliminohet nga AK-ja dhe jo të shpallet fitues.

Në nenin 6.4 të FDT-së ndër të tjera është kërkuar:

- **Vërtetimin e Gjykatës kompetente. Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që përmbush "kërkesat e përshtatshmërisë" Të mos jetë më i vjetër se tre muaj para Njoftimit për Kontratë,** kurse si dëshmi e kërkuar dokumentare - **Vërtetimin e gjykatës dokumenti dorëzohet pranë AK-së para njoftimit mbi vendimin e AK-së. në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi (oferta) në fjalë do të refuzohet.**

Gjatë qasjes në dokumentacion ne kemi vërejtur se ky vërtetim nuk është dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, prandaj edhe për këtë arsye A.K ka bere shkelje sepse OE është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka dorëzuar edhe vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa në nenin 6.4 të FDT-së është kërkuar "

- **Vërtetimi i ATK duhet të jetë origjinal me bar cod, dokumenti dorëzohet pranë AK-së para njoftimit mbi vendimin e AK-së. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi (oferta) në fjalë do të refuzohet"**

Në mungesë të këtyre dokumenteve OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe eshte dashur qe ne fillim te eleminohet nga gara.

Në nenin 9.1&9.2 të FDT është kërkuar "**Ofertuesi duhet të ofroj dëshmi se ka kontratë apo kontrata të përfunduara furnizim me inventar ne tri vitet e shkuara nga Data e Publikimit të Njoftimit për Kontratë, vlera e përgjithshme monetare e furnizimeve për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik jo më e vogël se: <u>Gjashtëqind Mijë Euro; 600,000.00 €</u>,** kurse si dëshmi dokumentare është kërkuar **"Lista e kontratave të realizuara se bashku me referenca. Ose raportin e pranimit nga komisioni ku ne raport konstaton se kontrata është përmbyll ne tersi nga data e hyrjes ne fuqi deri ne datën e përmbylljes ne kohëzgjatje prej Vite, Muaj , Ditë)**

OE nuk ka prezantuar kontrata për referencat e ofruara, kurse kontratat janë të viteve 2018 dhe 2019, ndërsa referencat i ka të vitit 2021!!!! prandaj këto dëshmi nuk mund dhe nuk duhet të merren parasysh, A.K eshte dashur MOS e favorizoj O.E

Në FDT, tek neni 9.1&9.2 I FDT-së është kërkuar si në vijim: "OE duhet ta ofroj katalogun për secilin artikuj veç e veç te evidentohen sipas numrit Rendor dhe te dëshmohet me fotografi për secilin artikuj.

OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar katalog për secilin artikuj veç e veç dhe nuk i ka evidentuar por i ka vendos disa foto te shlyera dhe nuk duken se çfarë produkte janë dhe se çka janë.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar edhe me çmime jo normalisht të ultë, ndërsa te disa produkte ka ofruar çmime shumë më të larta se sa çmimet e tregut, prandaj rezulton se ky OE ka ofertuar me çmime manipulative.

Çmimet manipuluese

Nr. Artikullit	Artikujt	Çmimet shumë te ulëta-manipuluese	Çmimet shumë të larta-manipuluse
1	**Tavoline pune për zyre 140x70x74** 		**100 euro**
2	**Tavoline pune për administrate (zyre) 160x70x74** 	**50 euro** Nuk është e mundur që tavolina më e madhe të kushtoj më lirë!	
3	**Tavolinë pune për zyre e vogël 125x125x74cm** 	**35 euro**	
4	**Tavolinë për Kompjuter 80x70x73cm**	**30 euro**	

5	**Kabinet për gjyqtar me tavolinë pune me kënd 160x80x90x80cm**		**200 euro**
7	**Tavoline për takime për 8 karrige**	**35 euro**	
8	**Tavolina për takime për 22 persona**	**40 euro**	
9	**Karrika lëvizëse për Gjyqtar**		**220 euro**
10	**Karrika lëvizëse për Zyrtar**		**100 euro**
11	**Karriga statike për palë**		**50 euro**
12	**Karrika statike për tavolina të mbledhjeve**	**30 euro**	
14	**Ulëse për pritje për 3 persona**	**45 euro**	
17	**Vitrine e hapur** 		**100 euro**

18	**Frigorifer**	**60 euro**	
19	**Komod për TV**	**30 euro**	
20	**Vitrine me 6 dyer për zyre**	**50 euro** Si eshte e mundur me kushtu ma lire vitrina 6 dyer se vitrina 4 dyer	
21	**Vitrine me 4 dyer për zyre**		**150 euro**
22	**Vitrine me 2 dyer për zyre** 	**45 euro**	

23	**Fotele një ulëse për pritje**	**35 euro**	
24	**Fotele dy ulëse për pritje** 	**40 euro**	
25	**Fotele tre ulëse për pritje** 	**50 euro**	
26	**Rafte për shkrimore**	**40 euro**	

27	**Rafte për shkrimore 2** 	**50 euro**	
34	**Rafte Metalike për Arkiv - 2**	**35 euro**	
35	**Rafte për Arkiv tipi - 3 Dim.**100 x 40 x 200cm Konstruksioni te punohet nga **tuba metalik 25x25 mm**, me muri te tubit 2 mm	**45 euro**	
36	**Kasete metalike me katër sirtar** 	**60 euro**	

37	**Ormanët Metalik dy dyer dim. 200x90x41cm** 	**62 euro**	
38	**Ulëse për pritje në holle**	**40 euro**	
39	**Karrikat për publikun, ne sallën e gjykimit**		**220 euro**
40	**Tavolinë në sallë të gjykimeve për 3 gjyqtar** 	**35 euro**	
41	**Tavolinë në sallë te gjykimeve për 5 gjyqtar** 	**40 euro**	

42	**Tavolina për prokuror dhe për avokat.** 	**35 euro**	
43	**Tavolina e procesmbajtësit** 	**35 euro**	
44	**Tavolinë për dëshmitar** 	**35 euro**	
45	**Rrethoja ndarëse ne sallën e gjykimit** 	**10 euro**	
47	**Veshja e mureve me iver pllaka**		**65 euro**

48	**Tavolinë pune për vendosjen e paisjese ne dy nivele me gjerësi 280 cm** 	**40 euro**	
49	**<u>Tavolin pune për vendosjen e paisjeve ne dy nivele me gjerësi 195 cm</u>** 	**35 euro**	

Nr	Artikujt	**Origjina**	
9	**Karrika lëvizëse për Gjyqtar**	**Nuk prodhohen ne Kosovë**	
10	**Karrika lëvizëse për Zyrtar**	**Nuk prodhohen ne Kosovë**	
12	**Karrika statike për tavolina të mbledhjeve**	**Nuk prodhohen ne Kosovë**	
18	**Frigorifer**	**Nuk prodhohen ne Kosovë**	

Duke u bazuar në tabelën e mësipërme shihen qartë çmimet jo normalisht të ulëta në pozicionet që i cekëm, e po ashtu shihen edhe çmimet shumë të larta në krahasim me çmimet e tregut, e ku kuptohet qartë që OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime manipulative.

Autoriteti kontraktues, nuk e ka zbatuar nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores Nr.001/2022 për prokurim publik sepse nuk ka kërkuar sqarime për çmimet jo normalisht të ulëta dhe te larte edhe pse këto çmime nuk mund të arsyetohen fare.

Ne dyshojme qe ky tender eshte i kurdisur sepse O.E Mobelland i rekomanduar per kontrate ka ofertuar me çmime manipulative, kur themi kurdisje tenderit shihet qarte se çmimet e ofruara nuk jan çmime te tregut sepse kemi dy EKSTREMITETE Çmime shume te larta dhe çmime shume te uleta.

Dyshojme qe OE i rekomanduar per kontrate ka marrveshje sepse artikujt qe duhet te porositen jane çmime te larta kurse artikujt qe nuk kerkohen jan çmime ekstremisht te uleta!!!!

Ne si popull apo shoqeri jemi te brengosur se si nje Institucion shume i rendesishem i shtetit tonë si Keshilli Gjygjsor i Kosoves apo njera nder shtyllat kryesore te Republikes se Kosoves punohet e veprohet ne kete menyre, rekomandohet per kontrate O.E me çmime manipulative me te vertet eshte shume per tu brengos!!!!

Gjithashtu siç e sqaruam më lartë për produktet që janë të vendosura në fund të tabelës, ato produkte nuk kane origjine nga OE i rekomanduar per kontrate sepse nuk prodhohen në Kosovë siç ka pretenduar OE i rekomanduar për kontratë, edhe KGJK e dinë shume mire sepse keta nuk jetojn ne hënë por ne Kosove

Gjithashtu ne pajtohemi me arsyet e eliminimit të OE "Euro Testing shpk" të cilat AK-ja i ka cekur në letrën standarde për tenderues të eliminuar.

Ne me dt. 05.01.2023 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që AK-ja **nuk e ka arsyetuar me fakte** dhe dëshmi konkrete vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.

AK-ja në vendimin e saj për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në lidhje me pretendimet tona ankimore, sa i përket kontratave dhe vërtetimeve nga gjykata dhe ATK, ka bashkangjitur dëshmitë, e të cilat dëshmi neve gjatë qasjes së dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë nuk na janë ofruar, mirëpo ne nuk e dijmë se kur i ka ofruar këto dokumentet, OE i rekomanduar për kontratë, pasi që askund nuk figuron data se kur janë prezantuar dëshmitë të cilat i ka bashkangjitur AK-ja në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, pra ne dyshojme se ato AK i ka pranuar pasi ne kemi bere kerkese per Rishqyrtim.

Se AK-ja po e favorizon haptas OE të rekomanduar për kontratë vërtetohet shumë qartë ky fakt, ku e njëjta nuk i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, pasi që nuk ka dhënë përgjigje fare në lidhje me çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë. E njëjta nuk ka dhënë përgjigje fare as në pretendimin tjetër ankimor, në lidhje me produktet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë për të cilat ne e kemi cekur se të njëjtat nuk prodhohen në Kosovë, pra ne dyshojme se ketu ka korrupsion.

Përderisa AK-ja nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet të cilat i cekëm më lartë atëherë kuptohet qartë fakti se pretendimet tona ankimore, janë të qëndrueshme, pasi që nëse të njëjtat nuk do të ishin të qëndrueshme atëherë AK-ja do ti kundërshtonte të njëjtat me fakte dhe dëshmi konkrete. Pra nga ky fakt

kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga AK-ja dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Gjithashtu AK-ja në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket kinse katalogut të ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, ku ne e kemi cekur se i njëjti katalog është vetëm kopje e specifikave teknike të cilat AK-ja i ka prezantuar në dosje të tenderit, AK-ja këtë pretendim e ka cilësuar si të pa bazuar.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në lidhje me pretendimin tonë të lartcekur, e njëjta e cek se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalogun me të cilin dëshmon se janë ofruar të gjithë artikujt sipas dosjes së tenderit. Ky konstatim i AK-së është i pa bazuar për faktin se ne në kërkesë për rishqyrtim e kemi cekur qartë se i njëjti OE ka prezantuar vetëm foto dhe ato foto i ka kopjuar bashkë me specifikimet nga dosja e tenderit, pra ka vendosur foto të marra nga dosja e tenderit. Andaj ky fakt tregon qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën në lidhje me katalogun për faktin se nuk e ka prezantuar katalogun konform kërkesës së dosjes së tenderit, andaj edhe arsyetimi i AK-së është i pa bazuar.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët të peshuar, pra nuk është respektuar kriteri kryesor për dhënie të kontratës sipas nenit 60 të LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, edhe pse janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Po ashtu autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj Ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"GRANITI SH.P.K"**
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERSIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesës në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*